

Data 20.08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kamion vetshkarkues”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Automjete
34100000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 4 583 333 (katër milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa T.V.SH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gjirokaster** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

.....
(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2023, 2024, 2025**) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo me te vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në vlerën e fondit limit, vlera është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "b", të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "b", e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit** të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20. % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit me shpenzimet e veta.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës deklaron se malli i ofruar përmbush të gjitha specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ngarkojë në SPE foto të automjetit si dhe katalogun teknik të prodhimit të përkthyer dhe noterizuar të kësaj të fundit ku të jenë të evidentueshme secila prej specifikimeve të kërkuara nga ana e AK ose Leje e Qarkullimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mjetet e kërkuara si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

2.7Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë për garancinë e automjetit për një periudhën **6 (gjashtë) mujore** nga data e dorëzimit tek AK.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.8Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Kamion Vetshkarkues 18 ton (4×4)

1. Gjendja

I përdorur, në gjendje shumë të mirë pune.

2. Viti i prodhimit

Jo më i hershëm se 2012 (te perfshihet dhe 2012)

3. Kilometrazhi

Jo më shumë se 250 000 km.

4. Origjina

Prodhim evropian ose amerikan.

5. Motori

Naftë.

Euro 5 ose më i lartë.

Minimum 290 HP(213 KW)

Vellimi minimum 6800 cc.

6. Transmisioni

4×4 permanent ose me aktivizim.

Kambio manuale

Minimum 8 marsha përpara.

7. Pesha

Pesha maksimale e lejuar minimum 18 000 kg.

Kapaciteti mbajtës i karrocëris minimum 10 000 kg.

8. Boshtet

2 akse.

Boshti i pasëm me dopio goma.

Bllokim diferenciali.

9. Karrocëria

Vetëshkarkim në tre anë.

Dysheme çeliku rezistent ndaj konsumit.

10. Kabina

2 vende.

Kondicioner.

ABS.

ESP.

Airbag.

Radio.

Pasqyra elektrike.

11. Sistemi hidraulik

Hidraulik funksional.

Pa rrjedhje.

12. Gomat

Minimum 60% te pa konsumuar.

Të gjitha në gjendje pune.

13. Pajisje sinjalizuese të nevojshme për të patur mjeti:

Trekëndësh.

Fikëse zjarri.

Kompleti i veglave.

Çelës rrotash.

Krik.

Mjeti të jetë i gatshëm për regjistrim dhe përdorim.

Mjeti të jetë i pajisur me ;

1. Leje qarkullimi
2. Targe
3. Çertifikat pronësie
4. Akt kolaudimi I mjetit
5. Siguracion
6. Taksavjetore e mjetit.

Garancia: Minimumi 6 muaj.

Automjeti do te kete garanci difektesh per nje perjudhe **6 (gjashtë)** mujore nga dita e dorzimit tek investitori dhe shitesi do te pergjigjet per riparimin e difekteve jo me vone se tre dite nga data e njoftimit.

Difektet të cilat perfshin perjudha e garancise jane si më poshtë;

- difekte motorike
- difekte të kutise së shpejtesisë
- difekte të trasmesionit
- difekte të valvulave dhe paketave elektrike
- difekte në lidhjen me sistemet hidraulike (pompa e hidraulikut)

Percaktimi i shkakut te difektit do te kryhet nga nje ekspert i miratuar me pelqimin e paleve.

ARGUMENTIM I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Argumentimi ligjor: Specifikimet teknike të emësipërme bazohet në nenin 36 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi teknik: Përcaktimi i specifikimeve teknike për blerjen e **një kamioni vetëshkarkues 18 ton, 4×4**, është bërë në funksion të nevojave të Bashkisë për transportin dhe shkarkimin e materialeve të ndërtimit, inerteve, zhavorrit, dheut dhe materialeve të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen e rrugëve dhe realizimin e punimeve publike.

Kërkesa për **mjet të përdorur, të prodhuar jo më herët se viti 2012, me kilometrazh deri në 250,000 km dhe në gjendje shumë të mirë pune**, synon të sigurojë një mjet me jetëgjatësi dhe besueshmëri të përshtatshme për përdorim intensiv, duke ruajtur njëkohësisht eficiencën ekonomike të investimit.

Kërkesa që mjeti të jetë **me prodhim evropian ose amerikan** është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën profesionale të mjetit dhe përdorimin e tij të parashikuar nga Drejtoria, i cili do të jetë intensiv dhe në kushte të ndryshme pune, përfshirë transportin e materialeve dhe operimin në terrene të vështira.

Kjo kërkesë lidhet me nevojën për sigurimin e një mjeti me **nivel të përshtatshëm cilësie konstruktive, qëndrueshmërie, sigurie dhe besueshmërie teknike**, duke marrë në konsideratë standardet e prodhimit dhe kërkesat teknike që aplikohen për mjetet e rënda të destinuara për përdorim profesional.

Duke qenë se mjeti kërkohet i përdorur, përcaktimi i origjinës synon të kufizojë riskun e përzgjedhjes së një mjeti me cilësi ose dokumentacion teknik të pamjaftueshëm dhe të sigurojë që automjeti të ketë një **histori dhe konfigurim teknik të verifikueshëm**, si dhe akses të përshtatshëm në pjesë këmbimi dhe shërbime mirëmbajtjeje.

Kërkesa është gjithashtu në funksion të **sigurisë dhe jetëgjatësisë së investimit publik**, pasi mjeti do të përdoret për transport të ngarkesave të rënda dhe në kushte pune që kërkojnë qëndrueshmëri të lartë të motorit, transmisionit, sistemeve të frenimit, shasisë dhe komponentëve të tjerë kryesorë.

Përcaktimi i këtij kriteri nuk lidhet me një markë ose prodhues të caktuar, por me kërkesën për një **nivel të caktuar cilësie dhe besueshmërie të mjetit**, duke lejuar pjesëmarrjen e çdo operatori ekonomik që mund të ofrojë një mjet që përmbush këtë kërkesë dhe të gjitha specifikimet e tjera teknike të përcaktuara.

Në këtë kuadër, origjina evropiane ose amerikane konsiderohet një element që, së bashku me vitin e prodhimit, kilometrazhin, standardin Euro, fuqinë, kapacitetin mbajtës, sistemin 4×4 dhe kërkesat e tjera teknike, synon të garantojë që mjeti i blerë të jetë **i përshtatshëm për përdorim të vazhdueshëm, i sigurt dhe ekonomikisht i qëndrueshëm për Bashkinë**.

Specifikimet për **motor naftë Euro 5 ose më të lartë, minimum 290 HP, volum motori minimum 6,800 cc, transmision 4×4 dhe minimum 8 marshe**, janë përcaktuar për të garantuar fuqinë, performancën dhe aftësinë e mjetit për të operuar me ngarkesa të konsiderueshme dhe në terrene të vështira.

Me **kambio manuale** është përcaktuar në funksion të karakteristikave të punës dhe kushteve të përdorimit të mjetit nga Drejtoria e Komunales.

Mjeti do të përdoret për **transportin e materialeve të ndërtimit, inerteve, zhavorrit, dheut dhe materialeve të tjera**, si dhe për ndërhyrje në mirëmbajtjen e rrugëve dhe infrastrukturës publike. Një pjesë e këtyre punimeve mund të zhvillohet në **rrugë të paasfaltuara, terrene me pjerrësi, sipërfaqe me baltë, zhavorr ose në zona ku kërkohet kontroll i lartë i lëvizjes së mjetit**.

Në këto kushte pune,ambio manuale i jep drejtuesit të mjetit **kontroll më të drejtpërdrejtë mbi zgjedhjen e marsheve**, duke bërë të mundur përshtatjen e shpejtësisë dhe fuqisë së transmetuar në rrota sipas ngarkesës, pjerrësisë së terrenit dhe kushteve të rrugës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për një mjet 4×4, i cili parashikohet të përdoret edhe në kushte të vështira terreni.

Kambio manuale mundëson gjithashtu përdorimin më efikas të **frenimit të motorit**, veçanërisht gjatë lëvizjes në zbritje dhe në terrene me pjerrësi, duke ndihmuar në kontrollin e mjetit dhe në reduktimin e përdorimit të vazhdueshëm të sistemit të frenimit.

Një tjetër arsye lidhet me **thjeshtësinë konstruktive dhe mirëmbajtjen**. Për një mjet pune që do të përdoret në mënyrë të vazhdueshme dhe në kushte të ndryshme operative, një transmision manual është më i përshtatshëm për nevojat e Drejtorisë së Kamunales, pasi mirëmbajtja dhe diagnostikimi i tij mund të kryhen më lehtësisht nga serviset që ofrojnë shërbime për mjete të rënda. Gjithashtu, riparimet e transmisionit manual janë përgjithësisht më të thjeshta dhe më pak komplekse në krahasim me sistemet automatike ose automatike të komanduar elektronikisht.

Kërkesa për **minimumi 8 marshe përpara**, në kombinim me kambion manuale, synon të sigurojë një raport të përshtatshëm midis fuqisë, shpejtësisë dhe ngarkesës, duke i dhënë drejtuesit mundësi për të zgjedhur marshin e përshtatshëm sipas situatës konkrete të punës.

Përcaktimi i kambios manuale lidhet edhe me **standardizimin e mënyrës së përdorimit të mjeteve nga stafi i Drejtorisë**, duke marrë në konsideratë eksperiencën dhe aftësitë e drejtuesve të mjeteve që do të operojnë këtë kategori automjeti.

Për sa më sipër, kërkesa për **kambio manuale** nuk përcaktohet për të favorizuar një markë, prodhues apo model të veçantë, por për shkak të **nevojave specifike operative të Drejtorisë, kushteve të terrenit, ngarkesave të transportuara, kërkesës për kontroll të drejtpërdrejtë të mjetit dhe lehtësisë së mirëmbajtjes dhe riparimit**.

Kjo kërkesë përbën një karakteristikë funksionale të mjetit dhe është konsideruar e nevojshme për garantimin e përdorimit të sigurt, eficient dhe ekonomik të kamionit gjatë kryerjes së shërbimeve publike.

Kërkesa për **peshë totale të lejuar minimum 18,000 kg dhe kapacitet mbajtës të karrocërisë minimum 10,000 kg**, si dhe për **dy akse, dopio goma në boshtin e pasëm dhe bllokim**

diferenciali, lidhet me nevojën për transport të sigurt dhe të qëndrueshëm të ngarkesave në kushte të ndryshme pune.

Karroceria me **vetëshkarkim në tre anë dhe dysHEME prej çeliku rezistent ndaj konsumit** është e nevojshme për rritjen e eficiencës së punës dhe përshtatjen e mjetit me llojet e materialeve që do të transportohen.

Pajisjet dhe sistemet e sigurisë, përfshirë **ABS, ESP, airbag, kondicionerin, pasqyrat elektrike dhe pajisjet sinjalizuese**, janë kërkuar për të garantuar sigurinë e drejtuesit të mjetit dhe përdorimin e tij në përputhje me kërkesat e sigurisë rrugore.

Kërkesat për **sistemin hidraulik funksional, gomat në gjendje të mirë dhe dokumentacionin e plotë të mjetit**, synojnë që mjeti të dorëzohet i gatshëm për regjistrim dhe përdorim të menjëhershëm nga Bashkia.

Garancia minimale **6 muaj** për komponentët kryesorë mekanikë, të transmisionit dhe sistemit hidraulik, si dhe detyrimi për ndërhyrje brenda afatit të përcaktuar, synojnë të mbrojnë interesat e Bashkisë dhe të sigurojnë funksionimin e rregullt të mjetit pas dorëzimit.

Në tërësi, këto specifikime janë përcaktuar në përputhje me **nevojat reale dhe funksionale të Bashkisë**, duke synuar sigurimin e një mjeti të përshtatshëm, të sigurt, të qëndrueshëm dhe ekonomikisht të arsyeshëm, në përputhje me fondin limit prej **4,583,333 lekë pa TVSH**. Specifikimet nuk synojnë një markë apo model të caktuar, por përcaktojnë kërkesat minimale funksionale që duhet të përmbushë mjeti.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT

Rigelsa Alikaj

Lorjana Shehu

Alfons Alikaj